




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

---

**RREGULLORE**  
**Për Pajisjet Personale Mbrojtëse në Punë**  
**(teksti i spastruar)**

Gjilan, dhjetor 2014.

Në bazë të neneve 11, 12 par. 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008), nenit 38 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën **30.12.2014**, miratoi këtë

## **RREGULLORE** **Për Pajisjet Personale Mbrojtëse në Punë**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1.**

Me këtë rregullore përcaktohen pajisjet personale mbrojtëse në punë me qëllim të përmirësimit të shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë në shërbimin civilë të komunës së Gjilanit.

#### **Neni 2.**

1. Në kuadër të përgjegjësi të tij, punëdhënësi (komuna) për vendet e punës në pajtim me ligjin dhe këtë rregullore, detyrohet të caktoj pajisjet personale mbrojtëse (PPM) si masë për siguri dhe shëndet në punë.
2. Lista e pajisjeve personale, mbrojtjes (PPM) për vendet e caktuara të punës në shërbimin civilë komunal është si në vijim.

<b>Nr.</b>	<b>Vendi i punës</b>	<b>Lloji i mjeteve të mbrojtjes personale</b>	<b>copë</b>	<b>Afati i vjetërsisë</b>	<b>Gardëroba e obliguar</b>
<b>1</b>	Vozitës	Rroba vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Dorëza pune	1	24 muaj	E obliguar
		Gëzof lëkure	1	36 muaj	E obliguar
<b>2</b>	Punëtor në sigurim dhe roje nate	Rroba pune vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba pune dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Këmishë	1	12 muaj	E obliguar
		Kravatë	1	12 muaj	E obliguar
		Këpuce gome	1	24 muaj	E obliguar
		Gëzof të përshtatshëm	1	36 muaj	E obliguar
<b>3</b>	Zjarrfikës	Rroba pune zjarrfikës vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Këpucë gome	1	18 muaj	E obliguar
		Maska për zjarrfikës	1	12 muaj	E obliguar
		Kravatë	1	12 muaj	e obliguar
<b>4</b>	Punëtor në kazantore Ndezës, saldues elektrik, ujëinstalues	Rroba pune	1	24 muaj	E obliguar
		Mantel pune	1	18 muaj	E obliguar
		Këpucë gome	1	12 muaj	E obliguar
		Kapela mbrojtëse	1	12 muaj	E obliguar
		Dorëza pune	1	18 muaj	E obliguar
		Syza mbrojtëse	1	Sipas nevojës	E obliguar

5	Inspektor (sanitar, ndërtimtarisë, bujqësisë, veterinarisë, ambientit, tregtisë, shërbimeve publike, pylltarisë dhe komunikacionit)	Rroba vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Këpucë vere	1	12 muaj	E obliguar
		Këpuce dimri	1	12 muaj	E obliguar
		Çantë pune	1	36 muaj	E obliguar
		Dorëza plastike për sanitari (polivinil)	1	Një përdorim	E obliguar
		Çizme gome për sanitari	1	18 muaj	E obliguar
6	Teknik i veterinarisë	Uniform (mantel)	1	06 muaj	E obliguar
		Pantallona plastike	1	06 muaj	E obliguar
		Çizme për punë	1	12 muaj	E obliguar
		Maska përdorimi	1	Një përdorim	E obliguar
7	Likuidues i qenve endacak	Maskë	1	Sipas nevojës	E obliguar
		Çizme gome	1	18 muaj	E obliguar
		Veshje gjuetie	1	18 muaj	E obliguar
8	Manipulues me bllokazha	Jelek ndriçues	1	12 muaj	E obliguar
		Rroba pune (kombinezone)	1	24 muaj	E obliguar
		Këpucë vere	1	12 muaj	E obliguar
		Këpuce dimri	1	12 muaj	E obliguar
9	Punëtor terreni, eksepeditues, inkasant dhe gjeodet	Rroba vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Këpucë vere	1	12 muaj	E obliguar
		Këpucë dimri	1	12 muaj	E obliguar
		Çantë	1	36 muaj	E obliguar
		Çizme gome	1	18 muaj	E obliguar
10	Arkivist i materialit, Operator në kompjuter	Mantel për punë	1	24 muaj	E obliguar
		Dorëza pune	1	12 muaj	E obliguar
11	Mjek veterinar	Mantel të bardhë	1	06 muaj	E obliguar
		Maskë mbrojtëse	1	Sipas nevojës	E obliguar
		Çizme pune për terren	1	12 muaj	E obliguar
12	Pastrues/mirëmbajtës	Rroba pune vere	1	24 muaj	E obliguar
		Rroba pune dimri	1	24 muaj	E obliguar
		Çizme gome për punë	1	12 muaj	E obliguar

3. Në vendet e punës ku është e detyrueshme mbajtja e uniformës së punës duhet të figuroj mbishkrimi i institucionit (përkatësisht, drejtorisë përkatëse).

### Neni 3

1. Mjetet për pajisje personale mbrojtëse (PPM) në pajtim me ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë e të përshkruara në nenin 2 të kësaj rregulloreje do të sigurohen nga punëdhënësi.
2. Punëdhënësi për punëmarrësit të cilët punojnë në nxemje (kazantore) dhe me aparat fotokopjues për shumëzim të materialit të KK-së e të cilët i ekspozohen gazrave, erërave të ndryshme, pluhurit, kushteve të përgjithshme higjienike dhe në rastet tjera ku konstatohet se ka koncentime të pluhurit dhe ajrit e që dëmtojnë shëndetin e punëmarrësve ka për obligim të sigurojë nga **një (1) litër qumësht** për çdo ditë pune për të punësuarin.

#### **Neni 4**

Ankesat dhe pakënaqësitë lidhur me ambientin e punës dhe PPM duhet t'i drejtohen menaxherit kadrovik të organit të punësimit dhe t'i drejtohen komisionit të ankesave.

#### **Neni 5**

Masat ndëshkimore do të jenë ato të përcaktuara me ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

### **II. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

#### **Neni 6**

1. Punëdhënësi (Komuna) obligohet që të sigurojë kushtet dhe masat e nevojshme të parapara me këtë rregullore.
2. Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë të përfshira me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

#### **Neni 7**

Me aprovimin e kësaj rregulloreje ç'fuqizohet rregullorja për sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës në shërbimin civilë të komunës **01. nr. 855/020** dt. **31.01.2005** dhe vendimin 01. nr. 5474 të dt. 05.06.2008 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për siguri në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës.

#### **Neni 8**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen e Komunës.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT**

**01. nr. 016-144326**  
**Gjilan, më 30.12.2014**

Kryesuesja e Kuvendit  
Valentina Bunjaku-Rexhepi

---